

Tiranë, 1 Maj 2026

DEKLARATË PUBLIKE

Koalicioni Shqiptar për të Drejtat në Punë

“Më shumë siguri, më pak aksidente – jeta e punëtorit mbi fitimin!”

Në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, Koalicioni Shqiptar për të Drejtat në Punë i përbërë nga Sindikata dhe Organizata të Shoqërisë Civile ngre shqetësimin për situatën alarmante të sigurisë në punë në Shqipëri.

Viti 2025 shënoi një bilanc tragjik: **48 punonjës humbën jetën në vendin e punës**, ndër të cilët **edhe 2 gra**, dhe qindra të tjerë u plagosën. Këto nuk janë thjesht statistika - janë jetë të humbura që pasqyrojnë dështimin sistematik të zbatimit të ligjit, mungesën e kontroleve efektive dhe papërgjegjshmërinë institucionale.

Ky fakt tregon qartë se pasiguria në punë prek të gjithë, por edhe se dimensionin gjinor të sigurisë dhe shëndetit në punë vazhdon të neglizhohet.

Siguria në punë në Shqipëri vazhdon të trajtohet si çështje dytësore, ndërkohë që realiteti kërkon ndërhyrje urgjente dhe të strukturuar.

Në këtë situatë alarmante, ne **kërkojmë veprim të menjëhershëm dhe të matshëm nga Qeveria dhe institucionet përgjegjëse:**

- Të rrisin urgjentisht numrin dhe efektivitetin e inspektimeve në punë, veçanërisht në sektorët me risk të lartë;

- Të garantojnë transparencë të plotë, raportim publik dhe përgjegjësi për çdo aksident dhe vdekje në punë;
- Të vendosin masa ndëshkuese reale dhe të zbatueshme ndaj punëdhënësve që shkelin rregullat e sigurisë;
- Të institucionalizojnë mjekësinë e punës si pjesë të sistemit publik;
- Të bëjnë efektive këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të sigurojnë mbrojtje efektive për punëtorët që denoncojnë shkeljet;
- Të forcojnë dhe bëjnë funksional dialogun social si mekanizëm real vendimmarrjeje.

Këto nuk janë kërkesa - janë detyrime ligjore dhe standarde minimale të një shteti që synon Bashkimin Europian.

Siguria në punë nuk është luks.

Jeta e punëtorit nuk mund të negociohet.

Koha për veprim është tani.

Koalicioni Shqiptar për të Drejtat në Punë

- Qendra për të Drejtat në Punë (CLR)
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC)
- Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonikë (SKOT)
- Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (SPSHSH)
- Sindikata e Sektorit Hidrokarbur (S.S.H)
- Levizja Rinore Egjiptiane dhe Rome (LRER)
- Drejtësi Sociale
- Sindikata e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SGPM)



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



- Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit Shqiptar (SPPSHSH)
- Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar (SBASH)
- Sindikata e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë (SPUSH)
- Sindikata e Zjarrëfikësve
- Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë (SGRSH)
- Sindikata e Shërbimeve Policiore të Shqipërisë (S.SH.P.SH.)
- Asosacioni i Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH)